

Njoftim

Sot, më datë **15.05.2023, ora 09:00**, trupi gjykues i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, i përbërë nga gjyqtarët:

- 1. Marsela Dervishi (Relatore);**
- 2. Alma Kolgjoka (Anëtare);**
- 3. Edlira Petri (Anëtare);**
- 4. Manjola Xhaxho (Anëtare);**
- 5. Emona Muçi (Anëtare).**

në seancë gjyqësore të zhvilluar në ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit, në adresën: Rr.“Ismail Qemali”, Tiranë, pasi shqyrtoi çështjen Nr.19 Regj.Themeltar, Datë 12.05.2023 Regjistrimi, me:

Paditës: Bashkia Shijak, përfaqësuar nga Teuta Plaku.

I paditur: Komisioni i Ankesave dhe Sanksioneve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Objekti: Shfuqizimin e Vendimit nr.84, datë 08.05.2023, të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve pranë KQZ-së.
Revokimin e dënimit me gjobë për kryetarin e bashkisë, z.Elton Arbana, në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Baza ligjore: Ligji nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” (Ndryshuar me ligjet nr.74/2012, datë 19.07.2012, nr.31/2015, datë 02.04.2015, nr.101/2020, datë 23.7.2020, nr.118/2020, datë 5.10.2020; shfuqizuar një pikë me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.28, datë 30.6.2021, shfuqizuar një fjali me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.31, datë 4.10.2021) neni 145 e vijues, neni 172.
Ligji nr.44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative” neni 108, Neni 113, 114; KREU II “Ankimimi administrativ” neni 130 e në vijim, neni 156 “njoftimi me mjete elektronike”.
Ligji nr.8116, datë 29.3.1996 dhe ndryshuar me ligjet nr.8431, datë 14.12.1998; nr.8491, datë 27.5.1999; nr.8535, datë 18.10.1999; nr.8812, datë 17.5.2001; nr.9953, datë 14.7.2008, nr.10052, datë 29.12.2008, nr.49/2012; 122/2013; 160/2013, neni 169 i K.Pr.Civile.

me Vendimin Nr.19, datë 15.05.2023, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, me shumicë votash,

VENDOSI

1. Pushimin e gjykimit të çështjes.
2. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
3. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.
U shpall në Tiranë më datë 15.05.2023.

Tiranë, më 15.05.2023.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë